



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 1145/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Shefki Shales anetar i LDK-se, konkretisht kandidat për asamble komunale të Fushe Kosovës paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) pas publikimit të rezultateve përfundimtare për kuvend komunal për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor dhe Manipulimit të votave, në seancën e panelit të mbajtur me 06.12.2013, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Shefki Shales kandidat për kuvendin komunal në Fushe Kosove nga rradhet e LDK-se dega në Fushe Kosove

Arsyetim

PZAP-i, më datë 03.12.2013 ka pranuar një ankesë nga Shefki Shala anetar i subjektit politik të LDK-se, konkretisht kandidat për asamble komunale të Komunes së Fushe Kosovës në të cilën pretendon se ka pasur manipulim i votave duke kërkuar nga KQZ-ja që të verifikojë edhe njëherë numrimin e votave në të gjitha vendvotimet në komunën e Fushe Kosovës duke dyshuar në votat e tija reale. Të verifikohen votat që janë shpallur të pavlefshme në vendvotimin në shkollën fillore “Bajram Curri” në Sllatinë të Madhe sepse këto vota janë të vlefshme.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

PZAP-i konstatoi se nga dëshmitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës si dhe nga pretendimet e ankuesit në ankesën e tij se ka ndodhur manipulimi i votave gjatë procesit zgjedhor vlerësohen si të pabazuara dhe të pa argumentuara në prova dhe dëshmi bindëse, siç pretendon pala ankuese në ankesën e saj, andaj ankesa e tillë është e pabazuar dhe se për këtë çështje PZAP-i në mbështetje të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe dhe nenit 3.6.pika c. vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 1145/2013 më datën 06.12.2013

Kryesuesi i Panelit
Ferit Osmani



Këshillë Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*